



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____Prot

Gjirokastër më ____ :____:2022

Lënda: **Raport për veprimtarinë e Këshillit Bashkiak Gjirokastër gjatë vitit 2021.**

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli i Bashkisë Gjirokastër, gjatë vitit 2021 është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur për një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit.

Këshilli Bashkiak si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit ka rol vendimmarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitorues.

Gjatë vitit 2021 Këshilli Bashkiak ka zhvilluar 3 mbledhje jashtë radhe dhe 12 mbledhje të planifikuara, gjithsej 15 mbledhje.

Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në vendime me karakter:

- 1. Financiar.**
- 2. Social.**
- 3. Infrastrukturë dhe strehimin.**
- 4. Problemet urbane dhe asetet publike.**
- 5. Emergjencat civile.**
- 6. Për arsimin dhe kulturën.**
- 7. Projektet e fituara nga ekzekutivi.**
- 8. Të ndryshme.**

Tematika e vendimmarrjes

- Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare për familje jo vetëm nga fondi i kushtëzuar por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Gjirokastër.
- Në vendimmarrjen e Këshillit vlen të përmendim miratimin e procedurave për zbatimin e Programeve Sociale të Strehimit në lidhje me “ Subvencionin e Qirasë”, Subvencionin e Interesave të Kredisë”, financuar me fonde të buxhetit të shtetit. Më pas u vazhdua me miratimin e ndryshimeve të Programit Social të Strehimit bazuar në Udhëzuesin Operacionail

dhe në miratimin e listës së familjeve aplikuese dhe masën e subvencionit të interesave të kredisë.

- Ka vazhduar edhe gjatë këtij viti mbështetja e familjeve që nuk kanë përfunduar procesin e privatizimit dhe lidhjen e kontratave para noterit.
- Vlen për t'u përmendur miratimi i projekt/ akteve që kanë të bëjnë me mbështetjen për emergjencat e ndodhura si pasojë e rënies së zjarrit dhe rrëshkitjes së tokës.(por është kërkuar në vazhdimësi sigurimi i banesave nga qytetarët)
- Janë miratuar sipërfaqe kullimore dhe bujqësore për t'u dhënë me qira.
- Në vendimmarrjen e tij Këshilli ka mbështetur projektet për të cilat ka aplikuar dhe i ka fituar ekzekutivi, duke mbështetur të gjitha këto projekte që I sjellin bashkisë shërbime të shtuara dhe përmirësim të infrastrukturës në territorin e bashkisë Gjirokastrë.
- Dhënien e titujve “Qytetar Nderi” për 4 qytetarë.
- Buxhetin e vitit 2021 dhe projekt-buxhetin afatmesëm të Bashkisë Gjirokastrë për vitet 2021-2023.
- Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Gjirokastrë për vitin 2021.
- Bursat për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe konviktet e shkollave të mesme profesionale, për vitin shkollor 2020-2021.

Për periudhën janar – dhjetor 2021, janë marrë gjithsej 109 vendime në Këshillin Bashkiak Gjirokastrë.

- Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë kanë qenë konform ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave.
- Për vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak për vitin 2021, institucioni i Prefektit të Qarkut është shprehur pozitivisht mbi ligjshmërisë e tyre.
- Nga sa thamë më lart, këto vendime të këshillit flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Gjirokastrës.
- Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qënë mjaft aktiv duke mbajtur mbledhje të radhës, mbledhje jashtë radhe sipas tabelës së mëposhtme:

Muaji	Nr. mbledhjeve	Mbledhje të radhës	Mbledhje jashtë rradhe
Janar	1	1	-
Shkurt	1	1	-
Mars	1	1	-
Prill	1	1	
Maj	2	1	1
Qershor	1	1	
Total	6	6	1
Total mujor parë	7	6	1
Korrik	2	1	1
Gusht	1	1	
Shtator	1	1	-

Tetor	1	1	1
Nëntor	2	1	
Dhjetor	2	1	
Total 6 mujor dytë	8	6	2

Periudha	Nr mbledhjeve	Mbledhje të radhës	Mbledhje jashtë rradhe
6 mujori parë	7	6	1
6 mujori dytë	8	6	2
Total 12 mujori	15	12	3

- Vlen për tu përmendur se pjesëmarrja e këshilltarëve ka qënë aktive si në mbledhjet e komisioneve ashtu dhe në procesin e vendimmarrjes në mbledhjet plenare online apo ato fizike në sallë.
- Komisionet e përhershme të këshillit janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar projekt vendime të sjella nga administrata e Bashkisë Gjirokastrë.
- Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014, “Për konsultimin Publik” gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, Këshilli ka mundur të ndjekë dëgjuesat publike në njësitë administrative, me shtresat në nevojë, bizneset dhe qytetarët.
- Përsa i përket miratimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022, të buxhetit të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2022 si dhe projekt-buxhetit afatmesëm të Bashkisë Gjirokastrë për vitet 2022-2025, Këshilli ka marrë pjesë në seanca dëgjimore së bashku me administratën e Bashkisë.
- Komisioni i Ekonomisë është mbledhur rregullisht për të gjitha projekt/ propozimet e ardhura nga ekzekutivi dhe vlen të përmendet puna e bërë në propozimet për hartimin e Paketës Fiskale për vitin 2022 dhe për hartimin e Buxhetit të vitit 2022, ku me përvojën e tyre kanë sjellë zërin e qytetarëve, biznesit dhe komuniteteve në miratimin e dy dokumenteve të rëndësishme mbi të cilat zhvillohet puna e ekzekutivit.
- U zhvillua në nëntor të vitit të kaluar Konferenca rajonale për turizmin dhe ekoturizmin në rajonin tonë me pjesëmarrjen e të gjitha bashkive të qarkut dhe këshillave bashkiake.
- U zhvillua TOËN-Hall në lidhje me informimin e qytetarëve për kanalet e komunikimit me Këshillin dhe mënyrën e dërgimit të kërkesave dhe ankesave.
- Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj. me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit, ku çdo këshilltar për aktet normative, për të cilat do të diskutohet dhe vendoset në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet.

- Në çdo mbledhje të këshillit nga ana e këshilltarëve është ngritur zëri për problematika që shqetësojnë qytetarët të cilat I janë paraqitur ekzekutivit për zgjidhje.
- Në mbledhjet e radhës të Këshillit Bashkiak janë marrë në analizë sipas planit të miratuar puna e drejtorive në shërbim të qytetarëve.
- Për sa më sipër ju falenderojmë secilin për kontributin e dhënë dhe ju ftojmë të jepni mendimet dhe sugjerimet tuaja për përmirësimin e punës së Këshillit Bashkiak.

KRYETAR I KËSHILLIT

Lavdi Hasani